



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE DHE SEKRETARËVE TË KZAZ-VE, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019, TË PROPOZUAR NGA
PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 02.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23 pika 1 gërma a, neni 29, neni 30, neni 31, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe propozimet e paraqitura nga partitë politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me Vendimin Nr. 18, datë 01.02.2019, dhe Vendimin nr. 19, datë 01.02.2019, ka caktuar partitë politike, që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), që do të ngrihen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019. Në bazë të përcaktimeve të akteve sipërcituar, Partia Socialiste e Shqipërisë, do të paraqesë tre kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve, dy kandidatura si parti e parë e shumicës parlamentare dhe kandidatura e tretë për të



Nr. 114 i Vendimit Data 02.04.2019 e Vendimit Ora 12.00 e vendimit

Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës
30 Qershor 2017, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë

realizuar barazpeshimin politik shumicë-opozitë në përbërjen e KZAZ-ve. Partia e parë dhe e dytë e opozitës parlamentare të cilat do të propozojnë anëtarë të KZAZ-ve, janë Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Lëvizja Socialiste për Integrim. Anëtari i shtatë i KZAZ-ve me numër çift do të propozohet nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Anëtari i shtatë i KZAZ-ve me numër tek do të propozohet nga Partia Demokratike.

Partia Socialiste e Shqipërisë ka paraqitur brenda afatit ligjor, shkresa nr. 1499, datë 18.03.2019 propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim nuk kanë paraqitur propozime.

Kandidatët e propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve, plotësojnë kërkesat e nenit 29, nenit 30, dhe nenit 31 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, propozimet përmbushin kriterin e përcaktuar në nenin 29, pika 1, germa "ç" të Kodit Zgjedhor, pasi 37% e kandidaturave të propozuara janë gra.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23 pika 1 germa a, nenin 29, nenin 30, nenin 31, të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të emërojë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas lidhjes Nr.1 bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare



Nr. 114 i Vendimit Data 02.04.2019 e Vendimit Ora 12.00 e vendimit

Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2017, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë